

RAPORT

Për monitorimin e fushatës zgjedhore 2019 të Subjektit “PARTIA DEMOKRACIA E RE EUROPIANE”

I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

A. INFORMACIONI LIGJOR

i. Kuadri ligjor

Baza ligjore: Ligji Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji “Per Partite Politike” Nr.8580, datë 17.02.2000 i ndryshuar me ligjin nr. 10374, datë 10.02.2011, ligjin nr. 17/2014, datë 20.02.2014, Ligjin nr. 25/2014, date 25.09.2014, ligjin nr. 90/2017.

Udhëzimi Nr.1, date 31.05.2017, “Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”

Vendimi nr.740, datë 31/05/2019 “Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve financiarë dhe auditueve ligjorë të cilët do të kryejnë monitorimin dhe auditimin e fondeve dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore nga subjektet zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019.

a. Kohëzgjatja e misionit

Periudha kohore nga data 01.06.2019 deri ne date 28.06.2019.

b. Fushëveprimi i monitorimit

i.Monitorimi i fushates zgjedhore te “Partia Demokracia e Re Europiane” për zgjedhjet lokale për vitin 2019.

Qarku Shkoder: F.Arrëz

Qarku Kukës: Has, Kukës

Qarku Lezhë: Lezhë

Qarku Tiranë: Vorë

Qarku Fier: Divjakë

Qarku Korçë: Pogradec



ii. Kontrata e shërbimit nr.5056, prot. Date 01.06.2019, me objekt “Kryerja e monitorimit të shpenzimeve të fushatës zgjedhore të partive politike, duke përfshirë aktivitetet, veprimtaritë dhe materialet e përdorura prej tyre gjatë fushatës zgjedhore në menyrë ligjore, të paanshme, transparente dhe profesionale si dhe çdo detyrim tjetër i parashikuar në këtë kontratë, në përputhje me Kodin Zgjedhor, ligjin nr.8580, date 17.02.2000, “Për Partitë Politike”, i ndryshuar me ligjin nr. 90/2017 dhe aktet nënligjore të KQZ të miratuara për këtë qëllim.

iii.Vendimi i KQZ-së nr. 740, datë 31.05.2019 -: Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e eksperteve financiarë dhe audituesve ligjorë, të cilet do të kryejnë monitorimin dhe auditimin e fondeve dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore nga subjektet zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019.

iv.Përgjegjësitë respektive të palëve, subjektit zgjedhor dhe ekspertit financiar/monitoruesit

Subjekti zgjedhor duhet të verë në dispozicion të ekspertit **financiar**/monitoruesit të caktuar nga KQZ çdo informacion, dokument apo të dhënë, që kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore për zgjedhjet lokale të vitit 2019.

Eksperti financiar/monitoruesi ka të drejtë që të kërkojë e verifikojë transaksionet e kryera për periudhën 3 muaj përpara e pas ditës së zgjedhjeve, nga persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, me qëllim evidentimin e transaksioneve të pajustificuara, e që mund të jenë përdorur për financim të paligjshëm të fushatës zgjedhore.

Eksperti financiar/monitoruesi kontrollon dokumentimin e shpenzimeve të subjekteve të treta në funksion të veprimtarisë së fushatës së subjektit zgjedhor, respektimin e kufirit maksimal të shpenzimeve (duke përfshirë këtu reklamën televizive e materialet propagandistike), zbatimin e dispozitave për financimin e fushatave elektorale të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, i ndryshuar dhe në ligjin nr.8580, datë 17.02.2000, i ndryshuar.

Eksperti financiar/monitoruesi ka për detyrë të detajojë në mënyrë të plotë të gjitha aktivitetet, veprimtaritë e materialet që ka përdorur subjekti zgjedhor gjatë fushatës.



Miratuar me vendimin Nr. 152 datë 11.04.2019

B.PARAQITJA E RAPORTIT TË MONITORIMIT DHE STRUKTURA E TIJ

ii. Prezantimi i subjektit zgjedhor

“Partia Demokracia e Re Europiane”, është regjistruar pranë Gjykatës me Vendimin Nr.65, datë 06.02.1997; 5305, datë 05.11.2004.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit nr.8580, datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar.

Qëllimi dhe objektivat e partisë pasqyrohen qartë në programin e Statutit të saj.

Organet më të larta drejtuese të partisë janë:

1. Kongresi
2. Këshilli Kombëtar
3. Kryesia e Partisë
4. Kryetari i Partisë

Kryetari i partisë është Z. Koçi Tahiri

iii. Struktura dhe objekti i raportit të monitorimit

a. Zyrat zgjedhore

Subjekti zgjedhor Partia Demokracia e Re Europiane nuk kishte hapur zyra zgjedhore.

b. Aktivitetet, eventet dhe materialet e fushatës

Subjekti zgjedhor “Partia Demokracia e Re Europiane” ka bërë takime individuale dhe në grupe të vogla me simpatizantë të saj. Gjatë fushatës zgjedhore nuk u bënë aktivitete të tjera, si mitingje, evente apo konferenca, dhe nuk u konstatuan pije apo ushqime.

Gjatë takimeve nuk janë evidentuar shpenzime për materiale të fushatës zgjedhore: si fletushka, reklama, flamuj, etj.

c. Vlerësimi i respektimit të kërkesave ligjore nga ana e subjektit zgjedhor

Nuk është evidentuar mosrespektim i kërkesave ligjore nga subjekti zgjedhor.

iv. Përmenden takimet dhe komunikimet e mundëshme midis ekspertit financiar dhe subjektit zgjedhor dhe çdo personi tjetër të tretë.

Pas lidhjes së kontratës me KQZ, për monitorimin e fushatës, eksperti financiar u njoh me të dhënat për subjektin zgjedhor. Sipas regjistrimit rezultoi se subjekti zgjedhor: “Partia Demokracia e Re Europiane” është me adresë: Rruga: Vangjel Note, nr.16, Laprakë, Tiranë me kryetar z. Koçi Tahiri, e financier z. Bajram Nela.

Eksperti financiar në datë 04.06.2019 kontaktoi në telefon me drejtuesin e subjektit zgjedhor, “Partia Demokracia e Re Europiane” z. Koçi Tahiri (Kryetar) për ti informuar në lidhje me punën që ne do të kryenim sipas kontratës me KQZ dhe njëkohësisht për të marrë informacionin e nevojshëm për aktivitetet e subjektit zgjedhor, zyrat elektorale, etj., për të filluar procesin e monitorimit në terren.



Miraturar me vendimin Nr. 152 datë 11.04.2019

Takimin me përfaqësuesit e subjektit zgjedhor e realizuam në datë 06.06.2019. Në takim ne e informuam përfaqësuesin e subjektit zgjedhor në lidhje me shërbimin që do të kryenim dhe kërkuam në mënyrë jo formale të njihemi me aktivitetet e subjektit zgjedhor “Partia Demokracia e Re Europiane” për fushatën zgjedhore 2019 dhe vendndodhjen e zyrave elektorale.

Ne datën 07.06.2019 i jemi drejtuar zyrtarisht kryetarit të partisë z. Koçi për dhenien e informacionit të nevojshëm për realizimin e objektit të punës sonë.

v. Jepet një paraqitje e përgjithshme në lidhje me raportin e monitorimit.

Subjekti zgjedhor është i detyruar që 35 dite para datës së zgjedheve të njoftojë me shkrim kryetarin e bashkise përkatëse për adresat e sakta të zyrave elektorale. Jo më vonë se 5 ditë nga marrja e informacionit, administrata e bashkisë bën verifikimin e zyrave elektorale e të respektimit të dispozitave të Udhëzimit “Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”.

Në datë 07.06.2019 ne ju drejtuam kërkesë zyrtare (kërkesë e dërguar me postë rekomande) të gjitha Bashkive të përcaktuara sipas njoftimit të dërguar nga ana Juaj, ku “Partia Demokracia e Re Europiane” kishte lista shumëemërore për kandidatë për këshillin bashkiak, në zbatim të kërkesave të Udhëzimit të KQZ-së, Nr.1, datë 31.05.2017.

Konkretisht Partia Demokracia e Re Europiane kishte lista shumëemërore për kandidatë për këshillin bashkiak si më poshte:

Qarku Shkodër: F.Arrëz

Qarku Kukës: Has, Kukës

Qarku Lezhë: Lezhë

Qarku Tiranë: Vorë

Qarku Fier: Divjakë

Qarku Korçë: Pogradec

Nga informacioni i marrë “Partia Demokracia e Re Europiane” nuk kishte hapur zyra elektorale në asnjë nga bashkitë, e për rrjedhojë nuk kishte afishim të materialeve propagandistike zgjedhore statike, përfshirë flamuj e postera në distancë jo më të madhe se 5 metra larg zyrës elektorale.

Gjithashtu gjatë fushatës “Partia Demokracia e Re Europiane” nuk ka kryer mitingje, evente apo takime elektorale.



Miraturar me vendimin Nr. 152 datë 11.04.2019

II. PËRMBLEDHJE / KËRKESAT FORMALE

A. PËRMBLEDHJE

1/ Identifikimi i subjektit zgjedhor në raportin e monitorimit		
a) identifikimi i subjektit zgjedhor (partia, kandidati/ja)	Po	Partia Demokratia e Re Europiane
b) identiteti i personit përgjegjës për financat	Po	Bajram Nela
c) evidenca e çeljes së llogarisë bankare	Ka hapur llogari të posaçme	Raiffaisen bankë
d) paraqitja e deklarimeve bankare që mbulojnë periudhën e fushatës	Po	Nxjerrjen e llogarisë bankare që mbulon periudhën e fushatës
2/ Nënshkrimi dhe data e paraqitjes së raportit të monitorimit		
Eksperti financiar	Po	Aida Maloku
Nënshkrimi	Po	25.11.2019
Dorëzimi i raportit të monitorimit	Po	26.11.2019
3/ Aktivitetet, eventet dhe materialet e monitoruara		
a) Zyrat zgjedhore	Po	Nuk u konstatuan zyra zgjedhore gjatë fushatës
b) Respektimi i ndalimit të aktiviteteve zgjedhore edhe nga ana e bashkive.	Po	Nuk u konstatuan parregullsi gjatë fushatës zgjedhore
c) aktivitetet	Jo	Nuk u organizuan aktivitete
d) eventet	Jo	Nuk u organizuan evente
e) materialet propagandistike	Jo	Nuk u konstatuan materiale propogandistike



Miratar me vendimin Nr. 152 datë 11.04.2019

B. ANALIZA
a/ Kërkesat formale

Llogari bankare e vecantë

- A është hapur llogaria vetëm për fushatën zgjedhore dhe për të marrë donacione që e kalojnë shumën prej 100,000 Lekë?
Eshtë hapur llogari bankare, nuk ka donacione që kalojnë shumën 100,000 lekë.
- Evidenca e hapjes së llogarisë bankare (data, dokumenti nga banka)?
Llogaria është hapur në Raiffaisen Bankë, datë 09.07.2019, është tërhequr nxjerrja e llogarisë bankare.
- Paraqitja e deklarimeve bankare që kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore?
Subjekti zgjedhor në llogarinë bankare të hapur për këtë qëllim nuk ka kryer transaksione bankare.
- Kush është personi përgjegjës i financave?
Përgjegjës për financat është z. Bajram Nela.

Procedura verifikimi

- Shkëmbim informacioni ndërmjet personit përgjegjës për financat/ partinë/ kandidatin/ çdo person fizik apo juridik
Financierit të partisë i është kërkuar llogarira për fushatën zgjedhore, e cila na është vënë në dispozicion.
- Informacioni i dhënë nga bankat dhe institucionet e tjera financiare dhe palët e treta
- Denoncimet/ ankesat e mbërritura në KQZ

Gjatë fushatës kemi komunikuar me Kryetarin e Partisë, nuk kemi marrë informacion nga palë të treta, nuk kemi informacion për ndonjë ankesë apo denoncim në lidhje me fushatën.



Miraturar me vendimin Nr. 152 datë 11.04.2019

1. Listat e kontrollit/ Tabela e raportimit

Listat kontrolluese (checklistat) 1-3 duhet të përdoren për regjistrimin e vëzhgimeve dhe llogaritjeve / vlerësimeve që kanë të bëjnë me elementet individuale të fushatës, të cilat dorëzohen në raportet e ndërmjetme gjatë fushatës zgjedhore. Këto lista kontrolli do të përdoren për të mbledhur të dhënat dhe informacionet që do të jepen në raportin përfundimtar të Monitorimit. Ato do të përdoren për të gjeneruar i) gjetje për raportet javore të dorëzuara në KQZ dhe ii) për të bërë një përmbledhje të konsoliduar të gjetjeve të monitorimit.

Lista1: Zyrat elektorale- nuk ka

Bashkia	F.Arrëz
Adresa	Nuk ka
Data dhe koha e vëzhgimit	14.06.2019 ora 13:00:00 PM-15:00:00PM
Madhësia e zyrës elektorale	Subjekti zgjedhor nuk ka hapur zyra elektorale
Deklarata e bashkisë (brenda 5 ditëve në pajtim me Udhëzimet nr. 1, datë 31.05.2017 "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore")	Bashkia F. Arrez ka deklaruar me shkresën nr.1793, datë 12.06.2019 se: Subjekti zgjedhor nuk ka asnje zyre te hapur ne territorin qe mbulon Bashkia Fushë Arrëz
Ekzistenca e një kontrate qiraje / marrëveshje qiraje	Nuk ka kontrate qeraje
Numri i stafit të vëzhguesve	2 persona nga stafi
Pajisjet e vërejtura	Nuk kemi konstatuar pajisje të përdorura nga subjekti zgjedhor
Vlerësimi i kostos së zyrës elektorale për periudhën e monitorimit	Gjatë monitorimit nuk konstatuam kosto te zyrës elektorale në bashkinë F. Arrëz

Bashkia	Has
Adresa	Nuk ka
Data dhe koha e vëzhgimit	24.06.2019 ora 14:00:00 PM-16:00:00PM
Madhësia e zyrës elektorale	Subjekti zgjedhor nuk ka hapur zyra elektorale
Deklarata e bashkisë (brenda 5 ditëve në pajtim me Udhëzimet nr. 1, datë 31.05.2017 "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore")	Bashkia Has ka deklaruar me shkresen nr. 1121/1prot, datë 11.06.2019 se: Për Subjektin zgjedhor nuk ka informacion në lidhje me adresat e zyrave zgjedhore
Ekzistenca e një kontrate qiraje / marrëveshje qiraje	Nuk ka kontrate qeraje
Numri i stafit të vëzhguesve	2 persona nga stafi
Pajisjet e vërejtura	Nuk kemi konstatuar pajisje të përdorura nga subjekti zgjedhor
Vlerësimi i kostos së zyrës elektorale për periudhën e monitorimit	Gjatë monitorimit nuk konstatuam kosto të zyrës elektorale në Bashkinë Has

Bashkia	Kukës
----------------	--------------



Miraturar me vendimin Nr. 152 datë 11.04.2019

Adresa	Nuk ka
Data dhe koha e vëzhgimit	24.06.2019 ora 10:00:00 AM-12:00:00AM
Madhësia e zyrës elektorale	Subjekti zgjedhor nuk ka hapur zyra elektorale
Deklarata e bashkisë (brenda 5 ditëve në pajtim me Udhëzimet nr. 1, datë 31.05.2017 "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore")	Bashkia Kukës nuk i ktheu përgjigje shkresës së dërguar nga ana jonë date 07.06.2019
Ekzistenca e një kontrate qiraje / marrëveshje qiraje	Nuk ka kontrate qeraje
Numri i stafit të vëzhguesve	2 persona nga stafi
Pajisjet e vërejtura	Nuk kemi konstatuar pajisje të përdorura nga subjekti zgjedhor
Vlerësimi i kostos së zyrës elektorale për periudhën e monitorimit	Gjatë monitorimit nuk konstatuam kosto të zyrës elektorale në Bashkinë Kukës

Bashkia	Lezhë
Adresa	Nuk ka
Data dhe koha e vëzhgimit	26.06.2019 ora 10:00:00 AM-12:00:00AM
Madhësia e zyrës elektorale	Subjekti zgjedhor nuk ka hapur zyra elektorale
Deklarata e bashkisë (brenda 5 ditëve në pajtim me Udhëzimet nr. 1, datë 31.05.2017 "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore")	Bashkia Lezhë nuk i ktheu përgjigje shkresës së dërguar nga ana jonë date 07.06.2019
Ekzistenca e një kontrate qiraje / marrëveshje qiraje	Nuk ka kontrate qeraje
Numri i stafit të vëzhguesve	1 person nga stafi
Pajisjet e vërejtura	Nuk kemi konstatuar pajisje të përdorura nga subjekti zgjedhor
Vlerësimi i kostos së zyrës elektorale për periudhën e monitorimit	Gjatë monitorimit nuk konstatuam kosto të zyrës elektorale në Bashkinë Lezhë

Bashkia	Vorë
Adresa	Nuk ka
Data dhe koha e vëzhgimit	27.06.2019 ora 16:00:00 PM-18:00:00PM
Madhësia e zyrës elektorale	Subjekti zgjedhor nuk ka hapur zyra elektorale
Deklarata e bashkisë (brenda 5 ditëve në pajtim me Udhëzimet nr. 1, datë 31.05.2017 "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore")	Bashkia Vorë nuk ktheu përgjigje, shkresës së dërguar nga ana jonë date 07.06.2019
Ekzistenca e një kontrate qiraje / marrëveshje qiraje	Nuk ka kontratë qeraje
Numri i stafit të vëzhguesve	1 person nga stafi
Pajisjet e vërejtura	Nuk kemi konstatuar pajisje të përdorura nga subjekti zgjedhor
Vlerësimi i kostos së zyrës elektorale për periudhën e monitorimit	Gjatë monitorimit nuk konstatuam kosto të zyrës elektorale në Bashkinë Vorë



Miraturar me vendimin Nr. 152 datë 11.04.2019

Bashkia	Divjake
Adresa	Nuk ka
Data dhe koha e vëzhgimit	27.06.2019 ora 10:00:00 AM-12:00:00AM
Madhësia e zyrës elektorale	Subjekti zgjedhor nuk ka hapur zyra elektorale
Deklarata e bashkisë (brenda 5 ditëve në pajtim me Udhëzimet nr. 1, datë 31.05.2017 "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore")	Bashkia Divjakë ka deklaruar se: Subjekti zgjedhor nuk ka hapur zyrë në Bashkinë Divjakë deri në datën e protokollimit të shkresës sonë datë 07.06.2019
Ekzistenca e një kontrate qiraje / marrëveshje qiraje	Nuk ka kontrate qeraje
Numri i stafit të vëzhguesve	1 person nga stafi
Pajisjet e vërejtura	Nuk kemi konstatuar pajisje të përdorura nga subjekti zgjedhor
Vlerësimi i kostos së zyrës elektorale për periudhën e monitorimit	Gjatë monitorimit nuk konstatuam kosto të zyrës elektorale në bashkinë Divjakë

Bashkia	Pogradec
Adresa	Nuk ka
Data dhe koha e vëzhgimit	15.06.2019 ora 16:00:00 PM-18:00:00PM
Madhësia e zyrës elektorale	Subjekti zgjedhor nuk ka hapur zyra elektorale
Deklarata e bashkisë (brenda 5 ditëve në pajtim me Udhëzimet nr. 1, datë 31.05.2017 "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore")	Bashkia Pogradec ka deklaruar me shkresën nr.4492/19prot, datë 13.06.2019 se: Për Subjektin zgjedhor nuk ka informacion në lidhje me adresat e zyrave zgjedhore
Ekzistenca e një kontrate qiraje / marrëveshje qiraje	Nuk ka kontrate qeraje
Numri i stafit të vëzhguesve	2 persona nga stafi
Pajisjet e vërejtura	Nuk kemi konstatuar pajisje të përdorura nga subjekti zgjedhor
Vlerësimi i kostos së zyrës elektorale për periudhën e monitorimit	Gjatë monitorimit nuk konstatuam kosto të zyrës elektorale në Bashkinë Pogradec

SHËNIM: Lista kontrolluese 1 duhet të përsëritet për çdo zyrë elektorale të vëzhguar. Raporti pastaj duhet të përmbajë një gjetje të shkurtër ku thuhet numri i zyrave zgjedhore të vëzhguara në vendndodhjen e monitoruar dhe nëse numri i zyrave është në përputhje me limitin e zyrave zgjedhore të përcaktuara me Udhëzimin Nr.1, të KQZ-së të datës 31.5.2017.



Miraturar me vendimin Nr. 152 datë 11.04.2019

Lista 2: Materiale propagandistike të fushatës zgjedhore të ndaluara (palejuara)

Bashkia		Të gjitha bashkitë në listën e kontrollit nr.1			
Data dhe koha e vëzhgimit		Sipas përshkrimit tek lista nr.1 e kontrollit			
Vendosja e materialeve propagandistike më shumë se 5 metra nga zyra zgjedhore		jo		jo	
Materialet e vërejtura					
Fotografitë e marra		Nuk kemi konstatuar materiale të ndaluara		Jo	
Tipi	Vendndodhja	Numri		Kostoja e parashikuar	
Psh. postera, banera, flamuj	Nuk kemi konstatuar	Nuk kemi konstatuar		Nga ana jonë nuk u vlerësua kosto	
Etj.					

Gjatë fushatës zgjedhore nuk konstatuam materiale propogandistike të palejuara.



Miratur me vendimin Nr. 152 datë 11.04.2019

Lista 3: Aktivitetet e fushatës

Partia/ Kandidati	Partia Demokracia e Re Europiane				
Lloji i eventit	Subjekti zgjedhor nuk organizoi miting apo konferenca gjatë fushatës zgjedhore				
Vendi dhe koha e fushatës	Qyteti, vendi dhe koha				
Vendtakimi për fushatën zgjedhore	Objektet e bashkisë, stadiumi ... (a është përdorimi i objekteve të tilla në mënyrë të barabarte, rastet e mundëshme të abuzimit të burimeve shtetërore)	Lokacioni privat, Hotel, sallë takimi, shtabi i partisë ...		Takimet janë organizuar në bare	
Madhësia dhe kapaciteti i vendit					
Numri i pjesëmarrësve	Numri (llogaritet ose vlerësohet - p.sh. bazuar në numrin e njerëzve në rresht)			Në takime grupet kanë qënë të vogla jo më shumë se 3-4 persona	
Stafi organizues	Stafi i partisë ose kandidatëve ose vullnetarët	Stafi i paguar, i siguruar nga kompania	Të tjerë		Në takime kanë qënë vetëm Drejtuesit e Partisë si dhe Kandidati për Anëtar Këshilli Bashkiak , në çdo takim nuk kanë qënë më shumë se 3-4 persona
Pije të ofruara	Përshkrimi (uji, pijet joalkoolike ...) dhe vlerësimi i përafërt i sasisë			Nuk konstatuam ofrimin e pijeve etj.	
Ushqimi i ofruar	Përshkrimi (sanduiçe, enët, ëmbëlsira, etj) dhe vlerësimi i përafërt i sasisë			Nuk konstatuam ofrimin e ushqimeve	
Argëtimi	Person (këngëtar, atlet, aktor, etj)			Nuk konstatuam persona të angazhuar për argëtim	
Transporti (për çdo automjet)	Qëllimi (transportimi i pjesëmarrësve, materialeve, të ftuarve, zyrtarët e partisë dhe kandidatët)	Mjet personal i Kryetarit			Eshtë përdorur mjet në pronësi të kryetarit
Mobilje dhe sistemi audio	Karrige	Tavolina	Video dhe sistemi audio	Të tjera	Nuk konstatuam përdorimin e mobiljeve Krrige e tavolina
Dhurata promocionale	Lloji (Bluza, stilolapsa, paratë, të tjera)		zero	Në asnjë takim nuk konstatuam dhurata, apo materiale promocionale	
Komente të tjera					



Miraturar me vendimin Nr. 152 datë 11.04.2019

Drejtuesit e subjektit zgjedhor bënë takime individuale në grupe te vogla me simpatizantë të saj. Gjatë fushatës zgjedhore nuk u bënë aktivitete të tjera, si mitingje apo konferenca, nuk u konstatuan pije apo ushqime. Nuk u konstatuan mobilje, foni, apo materiale promocionale.

Raportimet javore

Raporti javor i ndërmjetëm i monitorimit

Monitorues/Eksperti financiar: Aida Maloku

Zgjedhjet: Për Organet e Qeverisjes Vendore të Vitit 2019

Partia/subjekti elektoral: **Partia Demokracia e Re Europiane (PDRE)**

Rajoni dhe/ose bashkia të monitoruara: Fushë Arrëz, Lezhë, Has, Kukës, Pogradec, Vorë, Divjakë.

Periudha: 04/06/2019-10/06/2019.

Në kuadër të monitorimit u jemi drejtuar me shkresë të gjitha bashkive të vendit, të përcaktuara sipas njoftimit të dërguar nga ana Juaj. Deri në momentin e këtij raportimi, ne nuk kemi marre asnjë kthim përgjigje nga bashkitë përkatëse.

Njëkohësisht i jemi drejtuar zyrtarisht z. Koçi Tahiri, për të na vënë në dispozicion të gjithë informacionin e kërkuar nga ligji. Deri në momentin e këtij raportimi, ne nuk kemi marrë përgjigje.

Shkeljet e mundëshme të identifikuar të detyrimeve ligjore të fushatës zgjedhore

Gjatë periudhës së raportimit nuk kemi identifikuar shkelje të detyrimeve ligjore të fushatës zgjedhore.

Zyrat elektorale

PDRE nuk ka hapur zyra elektorale dhe ka zhvilluar takime me kandidatët e PDRE për Keshillat Bashkiakë në ambiente publike (bare).

Materiale të fushatës të ndaluara

Nuk ka zyra elektorale dhe nuk kemi konstatuar materiale të ndaluara të fushatës.

Raporti javor i ndërmjetëm i monitorimit

Monitorues/Eksperti financiar: Aida Maloku

Zgjedhjet: Për Organet e Qeverisjes Vendore të Vitit 2019

Partia/subjekti elektoral: **Partia Demokracia e Re Europiane (PDRE)**

Rajoni dhe/ose bashkia të monitoruara: Fushë Arrëz, Lezhë, Has, Kukës, Pogradec, Vorë, Divjakë.

Periudha: 10/06/2019-16/06/2019

Ne raportin e monitorimit për javën e parë ju kemi informuar se u jemi drejtuar me shkresë të gjitha bashkive të vendit, të përcaktuara sipas njoftimit të dërguar nga ana Juaj. Njëkohësisht i jemi drejtuar zyrtarisht z. Koçi Tahiri, për të na vënë në dispozicion të gjithë informacionin e kërkuar nga ligji.

Deri në momentin hartimit të këtij raporti, ne kemi marrë përgjigje nga:

- Bashkia Has e cila nuk ka informacion për adresën e saktë të këtij subjekti zgjedhor.



Miraturar me vendimin Nr. 152 datë 11.04.2019

- Bashkia Pogradec thekson se subjekti nuk ka informuar bashkinë lidhur me vendndodhjen e zyrave, për këtë arsye janë të pamundura adresat e sakta të zyrave elektorale.
- Bashkia Divjakë bën me dije se subjekti Partia Demokracia e Re Europiane nuk ka zyra elektorale të hapura në territorin e Bashkisë Divjakë deri në datën e protokollimit të shkresës sonë.

Jemi takuar me kryetarin e Partisë Demokracia e Re Europiane dhe na ka konfirmuar se nuk zyra të hapura për fushatën elektorale dhe nuk ka përdorur materiale të ndaluara për fushatën.

Shkeljet e mundëshme të identifikuara të detyrimeve ligjore të fushatës zgjedhore

Gjate periudhës së raportitmit nuk kemi identifikuar shkelje të detyrimeve ligjore të fushatës zgjedhore.

Zyrat elektorale

PDRE nuk ka hapur zyra elektorale dhe ka zhvilluar takime me kandidatet e PDRE për Këshillat Bashkiake në ambiente publike (bare).

Materiale të fushatës të ndaluara

Nuk ka zyra elektorale dhe nuk kemi konstatuar materiale të ndaluara të fushatës.

Raporti javor i ndërmjetëm i monitorimit

Monitorues/Eksperti financiar: Aida Maloku

Zgjedhjet: Për Organet e Qeverisjes Vendore të Vitit 2019.

Partia/subjekti electoral: **Partia Demokracia e Re Europiane (PDRE).**

Rajoni dhe/ose bashkia të monitoruara: Fushë Arrëz, Lezhë, Has, Kukës, Pogradec, Vorë, Divjakë.

Periudha: 17/06/2019-23/06/2019.

Në kuadër të monitorimit gjatë kësaj jave nga shkresat e derguara bashkive na ka ardhur përgjigje nga Bashkia Tiranë ku thuhet se subjekti zgjedhor “Partia Demokracia e Re Europiane” nuk ka sjellë adresat e sakta të Zyrave Elektorale të kësaj partie në Bashkinë Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019, sipas Udhezimit të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve Nr.1, datë 31.05.2017 “Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet e afishimit të tyre gjate fushates zgjedhore”.

Njëkohësisht kemi komunikuar me drejtuesin e subjektit zgjedhor të PDRE, z. Koçi Tahiri, për të na informuar për takimet elektorale.

Shkeljet e mundëshme të identifikuara të detyrimeve ligjore të fushatës zgjedhore

Gjatë periudhës së raportitmit nuk kemi identifikuar shkelje të detyrimeve ligjore të fushatës zgjedhore

Zyrat elektorale

PDRE nuk ka hapur zyra elektorale dhe ka zhvilluar takime me kandidatët e PDRE për Këshillat Bashkiake në ambiente publike (bare).

Materiale të fushatës të ndaluara

Nuk ka zyra elektorale dhe nuk kemi konstatuar materiale të ndaluara të fushatës.



Miraturar me vendimin Nr. 152 datë 11.04.2019

Raporti javor i ndërmjetëm i monitorimit

Monitorues/Eksperti financiar: Aida Maloku

Zgjedhjet: Për Organet e Qeverisjes Vendore të Vitit 2019.

Partia/subjekti elektorale: **Partia Demokratia e Re Europiane (PDRE).**

Rajoni dhe/ose bashkia të monitoruara: Fushë Arrëz, Lezhë, Has, Kukës, Pogradec, Vorë, Divjakë, Tiranë.

Periudha: 24/06/2019-28/06/2019.

Në kuadër të monitorimit gjatë kësaj jave na ka ardhur përgjigje nga Bashkia Fushë-Arrëz ku thuhet se Partia Demokratia e Re Europiane nuk ka asnjë zyrë elektorale në territorin që mbulon Bashkia Fushë Arrëz dhe subjekti në fjalë ka respektuar ligjin për perdorimin e materialeve propagandistike.

Gjatë kësaj jave kam kryer verifikime në qytetet Tiranë, Fier, Kukës dhe subjekti politik që unë monitoroj nuk ka patur të afishuara materiale propagandistike.

Shkeljet e mundëshme të identifikuar të detyrimeve ligjore të fushatës zgjedhore

Gjatë periudhës së raportitmit nuk kemi identifikuar shkelje të detyrimeve ligjore të fushatës zgjedhore.

Zyrat elektorale

PDRE nuk ka hapur zyra elektorale dhe ka zhvilluar takime me kandidatët e PDRE për Këshillat Bashkiake në ambiente publike (bare).

Materiale të fushatës të ndaluara

Nuk ka zyra elektorale dhe nuk kemi konstatuar materiale të ndaluara të fushatës.

Tiranë më 25/11/2019

Auditues Ligjor

Aida Maloku



LEKSPERTI KONTABEL
I AUTORIZUAR
AIDA MALOKU



Miraturar me vendimin Nr. 152 datë 11.04.2019